



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË
DREJTORIA E PYJEVE DHE KULLOTAVE

PROJEKT PYLLËZIMI

Emërtimi: *Pyllëzime Krushovë.*

Fshati: *Krushovë.*

Njësia Adm.: *Voskopojë.*

Emri popullor: *Shëndëllia.*

Ekonomia pyjore: *"Voskopojë 2"*

Parcela,n/parcela: *Nr. 121b.*

PROJEKTOI:

KONTROLLOI:

DREJTORI I PYJEVE DHE KULLOTAVE

MIRATOI:

KRYETARI I BASHKISË

Sotiraq FILO

VITI 2023

PËRMBAJTJA E PROJEKTIT

1. **KAPITULLI I-rë; KONSIDERATA TË PËRGJITHSHME**
 - 1.1.Konsiderata të përgjithshme.
 - 1.2.Qëllimi i projektit.
 - 1.3.Detyra e projektit.
 - 1.4.Vizioni i projektit.
 - 1.5.Konteksti i projektit dhe objektivat.
 - 1.6.Përshkrimi i objektivave të projektit.

2. **KAPITULLI II-të; STUDIMI I OBJEKTIT TË PLANIFIKUAR PËR PYLLËZIM**
 - 2.1 Vendosja Gjeografike dhe Administrative
 - 2.2 Siperfaqja e Objektivit.
 - 2.3 Rrjeti rrugor dhe largësia nga qendrat e banuara.
 - 2.4 Gjeomorfologjia,forma e terrenit dhe gjeologjia.
 - 2.5 Kundrejtimi i objektivit.
 - 2.6 Lartësia mbi nivelin e detit.
 - 2.7 Hidrologjia.
 - 2.8 Kushtet klimatike.
 - 2.9 Kushtet Pedologjike.
 - 2.10 Bimesia Egzistuese.

3. **KAPITULLI III-të; TEKNIKAT E KRYERJES SE PUNIMEVE**
 - 3.1 Zgjedhja e llojeve.
 - 3.2. Menyra e përgatitjes së tokës.
 - 3.3. Skema, formula dhe metoda e pyllëzimit.
 - 3.4 Materiali mbjellës.
 - 3.5 Koha e kryerjes së punimeve.
 - 3.6 Parashikimi i përparësive të punimeve.
 - 3.7 Sherbimet Kulturele dhe ruajtja.

4. **KAPITULLI IV-rt; VLERESIMI I PROJEKTIT**
 - 4.1 Grafiku i punimeve.
 - 4.2 Analiza e riskut.
 - 4.3 Qendrueshmeria e projektit.
 - 4.4 Ndikimi social ekonomik.
 - 4.5 Vleresimi dhe monitorimi.

5. **KAPITULLI V-të; ANEKSE**
 - 5.1 Skema e mbjelljes.
 - 5.2 Foto satelitore e pozicionimit të objektivit.
 - 5.3 Përshkrimi i llojit që do të përdoret për pyllëzim.
 - 5.4 Specifikime teknike

6. **KAPITULLI VI-të. PREVENTIVA**
 - 6.1 Preventiv

KAPITULLI I

KONSIDERATA TË PËRGJITHSHME

1. Të hartohet Projekt Pyllëzimi me Llojin “Pishë e Zezë” (*Pinus nigra*) dhe “Panjë Mali” (*Acer Pseudoplatanus*), në ngastrën Nr. 121b, të ekonomisë pyjore “Voskopojë 2” të cilat janë djegur nga zjarret.

1.1. Konsiderata të përgjithshme:

Objekti që duam të pyllëzojmë ndodhet në ngastrat pyjore nr. 121b, në ekonominë pyjore Voskopojë 2. Në këto ngastra ka filluar të shtohet erozioni pasi janë djegur në vitet 2007. Objekti në fjalë shtrihet në zonën fitoklimatike Fagetum dhe prek të gjitha kodrat dhe përrenjtë që shtrihen në Njësinë Administrative Voskopojë dhe konkretisht në ekonominë pyjore Voskopojë 2, në ngastrat pyjore nr. 121b. Sipas VKM. Nr. 433, date 08. 06. 2016 (shtojca 33), e ndryshuar, ngastra Nr. 121b, të ekonomisë pyjore ”Voskopojë 2”, janë në pronësi të Bashkisë Korçë dhe shtrihen në territorin e njësisë administrative Voskopojë, fshati Krushovë. Në sipërfaqen e këtyre ngastrave gjendet edhe bimësi barishtore e përbërë nga graminacea, leguminoze, etj. Nga vrojtimi në terren rezultoi se këto sipërfaqe pyjore janë të përshtatshme për t’u rehabilituar nëpërmjet pyllëzimit me fidanë të llojit Pishë e Zezë (*Pinus Nigra*) dhe Panjë Mali (*Acer Pseudoplatanus*). Qëllimi kryesor i kësaj ndërhyrjeje është të krijojë një masiv me pyje, i cili do të ndikojë në stabilizimin e terrenit dhe mbrojtjen nga fenomeni i erozionit.

1.2. Qëllimi i projektit:

Ndërhyrja me punime për pyllëzimin e sipërfaqes prej 21.0 ha, e cila aktualisht është pothuajse e zhveshur nga vegjetacioni pyjor, si pasojë e djegies së tyre nga zjarret, do të synojë në stabilizimin dhe mbrojtjen e objektit nga fenomeni i erozionit dhe gërryrjeve të tokës. Krijimi i një plantacioni me pyje të llojit Pishë e Zezë dhe Panjë Mali në objektin e propozuar, krahas funksionimit mbrojtës të tokës, do të ndikojë dhe në plotësimin e nevojave të komunitetit me lëndë drusore në të ardhmen, në menaxhimin e qëndrueshëm të fondit pyjor, në përmirësimin e peisazhit dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së banorëve në afërsi të tij.

1.3. Detyra e projektit:

Të sigurohet ripërtëritja artificiale nëpërmjet pyllëzimit me fidanë të llojit pyjor Pishë e Zezë dhe Panjë Mali në sipërfaqen e objektit ku do të realizohet pyllëzimi. Detyra kryesore e këtij projekti është që në përputhje me kushtet stacionare të objektit, të realizohen punimet e nevojshme për mbjelljen dhe për sigurimin e kushteve sa më optimale deri në instalimin e grumbullit të ri pyjor.

1.4. Vizioni i projektit:

Duke e vlerësuar në vend këtë sipërfaqe që aktualisht është sipërfaqe boshe, krijohet mundësia e shtimit të habitateve dhe rritjes së interesit të komunitetit për menaxhimin e qëndrueshëm të fondit pyjor. Duke vlerësuar të gjithë faktorët e tjerë ekologjik si biodiversitetin, klimën, tokën, erozionin, ndotjen, peisazhin, etj, e themi me plot bindjen se realizimi i këtij pyllëzimi do të ndikojë pozitivisht në të gjithë faktorët e sipër përmendur.

1.5. Konteksti i projektit dhe objektivat:

Ky projekt ka konceptin e ndërhyrjes me pyllëzime artificiale, për të bërë të mundur kthimin në gjendjen si ka qënë para zjarreve, krijimin dhe përmirësimin e peisazhit malor si dhe njëkohësisht shtimin e masës së gjelbërt dhe asaj drusore. Rrjedhimisht si rezultat i kësaj do të kemi një mjedis më të pastër që do ndikoj dhe në përmisimin e ndotjes së ajrit si dhe në shtimin e faunës dhe florës.

Me anë të kryerjes së pyllëzimeve, në këto parcela do të ndikojë drejtpërsëdrejti në radhë të parë në mbrojtjen e tokës, në përmirësimin e saj nëpërmjet sistemit rrënjor të bimës, së dyti do të ketë edhe një efekt shumë të rëndësishëm ekologjik, pasi llojet që ne kemi planifikuar të pyllëzojmë rregullon strukturën e tokës, frenojnë erozionin e mëtejshëm si dhe krijojnë mundësi të reja për zhvillimin dhe grumbullimin e bimëve mjeksore, gjithashtu do të reduktoje ndotjen duke rritur masën e fiksimit të dioksidit të karbonit në gjethe dhe përmisimin e peisazhit natyror.

Efekti i këtij pyllëzimi është edhe në shtimin e habitateve në terrene të degraduara, pasi druri i Pishës së Zezë është një dru me leverdishmeri ekonomike pasi është mjaft cilësor dhe i kërkuar nga industria e drurit.

Panja e Malit është e shquar për tolerancën kundrejt erës dhe ka vlera ekologjike të larta, që në perzjerje me specie të tjera mund të krijojë grumbuj me struktura të ndryshme.

1.6. Përshkrimi i objektivave të projektit:

Zbatimi i këtij projekti ka si objektiv rehabilitimin e këtyre sipërfaqeve të djegura, në një sipërfaqe pyjore e qeverisur si trungishte e cila do të arrihet duke e pyllëzuar me fidanë të llojit Pishë e Zezë dhe Panjë Mali.

Për këtë do të synohen këto objektiva:

1. Rritja e sipërfaqeve me habitate të ndryshme në nivel bashkie, duke kryer pyllëzime artificiale me lloje të tilla që i pershtaten kushteve stacionale të vendit. Gjithashtu garancia në ecurinë e këtij objekti do të jetë edhe cilësia e fidanëve që do të përdoren për pyllëzim si dhe gjendja fitosanitare e tyre, që do të thotë se fidanat duhet të merren nga fidanishte të çertifikuara, duke respektuar standartet e transportit të largët dhe të afërt në objekt pa dëmtuar fidanët, mënyrën e shtratifikimit si dhe nga serioziteti dhe cilësia e kryerjes së punimeve sipas zërave të preventivit.

2. Do të rriten vlerat e biodiversitetit, pasi në kushtet aktuale nuk mund të flitet për të. Me krijimin e këtij pylli në të ardhmen pas një periudhe 15-20 vjecare do të kemi një përmirësim si në rritje, volum, masë të gjelbert, përmirësim dhe pasurim toke me humus, do të kemi një imazh tjetër floristik dhe faunistik, do të kemi të zhvilluar faunen e egër, si dhe rritjen e kapacitetit të bimëve medicinale.

3. Me krijimin e këtij grumbulli të ri, do të përmirësohet bilanci i plotësimit të nevojave të komunitetit për lëndë drusore e prodhime të tjera si, bime mjeksore, kullotje dhe sigurimi i të ardhurave financiare nga tregu real dhe i organizuar e i monitoruar i këtyre produkteve në funksion të përmirësimit të kushteve ekonomiko-financiare të komunitetit si dhe duke siguruar të ardhura në funksion të Bashkisë Korçë.

4. Rritjen e sipërfaqeve të gjelbërta, si dhe përmisimin e peisazhit natyror.

KAPITULLI II

2. STUDIMI I OBJEKTIT TË PLANIFIKUAR PËR PYLLËZIM.

2.1 Vendosja gjeografike dhe administrative:

Objekti ndodhet në Jug-Perendim të fshatit Krushovë, në Ekonominë Pyjore “Voskopojë 2”, fshati Krushovë, Njësia Administrative Voskopojë, parcelat nr. 121b.

2.2 Siperfaqja:

Siperfaqja që do të përshkohet me punime pyllëzimi është **21.0** ha, e cila ndodhet në afërsi të fshatit Krushovë.

2.3 Rrjeti rrugor dhe largësia nga qendrat e banuara:

Objekti që do të pyllëzohet ndodhet në afërsi të fshatit Krushovë, ka nje distancë rreth 7 km nga nga qendra e Nj. Adm. Voskopojë, 30 km nga qyteti i Korçës.

2.4 Gjeomorfologjia, forma e terrenit, gjeologjia:

Objekti që do të pyllëzohet është shpat me pjerrësi mesatare (14°-20°), terreni jo shumë i aksidentuar, relievi paraqitet jo shume i valëzuar me disnivel të vogël lartësish.

2.5 Kundrejtimi:

Objekti ku do të kryhet pyllëzimi ndodhet në pjesën e anësore të rruës auto Voskopojë – Krushovë dhe ka kundrejtim Jug – Lindje.

2.6 Lartësia mbi nivel deti:

Lartësia e parcelave mbi nivelin e detit varion nga 1300-1380 m mbi nivelin e detit me një lartësi mesatare 1340 m mbi nivelin e detit.

2.7 Hidrologjia:

Objekti ku do të kryhet pyllëzimi, për sa i perket rrjetit hidrologjik ai pershkruhet nga disa rrëke në pjesën fundore të ngastrës të cilat nuk mbajnë ujë. Përroskat që përshkojnë objektin janë të zhvilluara si shkak i erozionit. Kjo dhe për faktin se objekti është zhveshur nga bimësia pyjore.

2.8 Kushtet Klimatike:

Klima e zonës ku shtrihet objekti që do të pyllëzohet kushtëzohet nga pozita gjeografike, konfiguracioni i relievit si edhe në diferencimet altitudinale. Mbështetur në ndarjen klimatike të vendit tonë si dhe pozicionin gjeografik, objekti përfshihen në zonën mesdhetare paramalore jug-lindore. Uljet dhe ngritjet e relievit ndikojnë në regjimin e elementeve klimatike dhe vecoritë e temperaturave, reshjeve etj.

Temperaturat e ajrit me regjimin e saj mesatar, me ecurinë e saj ditore, stinore e vjetore ndikon në menyre aktive mbi jetën dhe aktivitetin njerëzor, shtazor dhe bimor. Të dhënat klimatike për

zonën e studimit janë marrë nga Instituti Meteorologjik Tiranë, për periudhën 1951-2000 për stacionin e Korçës. Në zonën e Voskopojës, të dhënat klimatike sipas stacioneve jepen në tabelat e më poshtme:

Stac. Metr. Korçë	Muajt												Mes Vjet
	J	Sh	M	P	M	Q	K	G	Sh	T	N	Dh	
Temper. Mes.(°C)	-1	0.6	4.9	9.7	13.7	17.8	20.9	20.8	17.4	11.6	8.4	2.8	10.7
Reshjet mes.(mm)	75	67.4	55.7	49.2	61	45.6	24.7	25.3	44.4	79.3	108.5	97.8	733.8
Rap.Reshje/Temp.	-75	112	11.4	5.1	4.5	2.6	1.2	1.2	2.6	6.8	12.9	34.9	69

Bazuar në të dhënat klimatike rezulton se në zonë ka një periudhë thatësire (Raporti Reshje/Temp < 2) prej 2 muajsh (Korrik-Gusht). Kjo është periudha në të cilën krijohet edhe deficit i ujit dhe ku duhet të ndërhyhet me vaditje për të plotësuar nevojat e fidanëve për lagështi. Temperatura mesatare e vjetore është shënuar 10.7 gradë celcius, vlera maksimale e regjistruar ka qënë 20.9 °C kurse vlera mesatare minimale është shënuar -1. Numri më i madh i ditëve me temperaturë maksimale është regjistruar në muajin Korrik.

Reshjet

Si veçori e përgjithshme e reshjeve është se ato bien më tepër në shpatet perëndimore e jugperëndimore të maleve dhe më pak në shpatet lindore. Një shpërndarje e tillë është e lidhur me vendosjen e relievit dhe trajektoreve të lëvizjes së cikloneve. Zakonisht dimri e vjeshta janë të lagështa, pranvera e paqëndrueshme dhe vera është e thatë. Muajt me të thatë janë Korriku (24.7mm) dhe Gushti (25.3mm), kurse muajt më të lagësht janë Nëntori (108.5) dhe Dhjetori (97.8mm). Duke qënë se tokat janë tipike të murrme, reshjet sipërfaqësore shkaktojnë probleme me humbjen e shtresës sipërfaqësore dhe shfaqjen e shenjave të erozionit. Diagrama klimatike tregon se periudha kritike për fidanët që do të mbillen, është fillimi i muajit Korrik deri në javën e tretë të muajit Gusht. Ndaj, në këtë periudhë, duhen bërë edhe shërbimet kryesore (ujitje + prashitje) në sipërfaqet e pyllëzuara.

Reshjet në formë bore bien kryesisht gjatë muajve të dimrit. Në fshatrat që ndodhen në lartësi mbi 800 m, dëborat qëndron disa muaj. Numri i ditëve me shtresë borë në zonën e projektit është 90 ditë. Pra, bora përbën problem lidhur me pyllëzimet sidomos gjatë periudhës së dimrit.

2.9 Kushtet pedologjike:

Objekti përfshihet në tipin e **tokave të murrme pyjore**, me thellësi mesatare e cila varion nga 60-80 cm, me lageshti të tokës të fresket dhe me reaksion acid-neutral, të shperlara dhe pa lëgushe. Toka është me strukturë dhe me teksture rano-argjilore me gurë ne 8-10 % të sipërfaqes, me origjinë hidrike dhe me ecuri aktive, ku si pasojë e këtij fenomeni kemi dhe krijim përroskash të shumta në numër. Janë të lira jo të ngjeshura dhe të shperlara.

Toka përbën bazën natyrale të procesit të prodhimit, duke qënë rezultat i proceseve të gjata të zbrërthimit dhe alternimit të nënshtratit litologjik, në prani dhe nën ndikimin e bimësisë dhe të një klime të caktuar, shkëmbi amnor, reliev etj, Midis tokës dhe vegjetacionit që shkëmbejnë lidhje të ngushta me njëra-tjetrën, cilësitë e tokës ndikojnë në përberjen e vegjetacionit dhe mbulesa

bimore ka ndikim në formimin e tokës. Studimi i tokës është bazuar në vrojtimet e terrenit dhe nga Plani i Menaxhimit të ekonomisë pyjore Voskopojë 2.

2.10 Bimësia egzituuese:

Përdorimi i territorit i objektit të propozuar është sipërfaqe me bimësi pyjore. Gjendja vegetative në përgjithësi e degraduar. Ka pjesëmarje shkurresh të llojit Dëllinjë e Zezë dhe Bush. Mbulesa barishtore graminace, leguminace, me gradë veshje 5-10 %. Kjo sipërfaqe është përdorur dhe është kullotur sporadikisht, por duke parë zhvillimin e erozionit dhe zhvillimin e zonës, do të mbrohet pasi të pyllëzohet me fidanë pyjor të llojit Pishë të Zezë dhe Panjë Mali.

KAPITULLI III

3 TEKNIKA TE KRYERJES SË PUNIMEVE

3.1 Zgjedhja e llojeve.

Në zgjedhjen e llojit pyjor për pyllëzim, është marrë parasysh kombinimi i drejtë i tre elementeve kyesorë :

- a) Qëllimi i pyllëzimit;
- b) Kushtet e mjedisit, dhe;
- c) Veçoritë biologjike të llojit.

Për zgjedhjen e llojit pyjor jemi bazuar në **“Metodën e Ekologjisë të Krahasuar”** Kjo mënyrë zakonisht zbatohet për zgjedhjen e llojeve dhe prejardhjeve kur nuk kemi ngritur eksperimente dhe kur rezultatet kërkohen për një periudhë kohore të shkurter. Ajo lejon përdorimin e prejardhjeve mbi bazën e krahasimit të kushteve të biologjisë së njohur të llojeve në vendin e tyre me mjedisin, pa marrë në konsideratë aftësinë e tyre për përshtatje në kushte të reja. Duke qënë se Pisha e Zezë dhe Panjë e Malit ka një bonitet shumë të mirë gjatë ciklit të saj të rritjes si dhe përshtatet me klimatike, pedologjike dhe kushtet topografike të zonës ku ndodhet objekti, rekomandojmë që të përdoren për pyllëzim.

Përpërcaktimin e llojit që do të mbillet në objekt (*Pishë e Zezë dhe Panjë Mali*), janë marrë në konsideratë apo janë vlerësuar kritere si më poshtë:

- Ndikimi nga ngricat e pranverës ;
- Ekspozimi i specieve (ekspozimi ndaj klimës, tokës, kushteve ekstreme etj)
- Kërkesa e species, ndaj tokës (lëndëve ushqyese dhe elementëve të tjerë)
- Kërkesat ndaj dritës;
- Sistemi rrënjor

3.2 Mënyra e përgatitjes së tokës:

Gjatë zbatimit të këtij projekti do të kryhen punime pyllëzimi duke respektuar të gjithë parametrat teknik të projektit, që nga piketimi, hapja e gropave, ruatje e skemës së pyllëzimit, shtratifikimi dhe nxjerrja e fidaneve, mbjellja e tyre si dhe shërbimet kulturore për tre vite. Te gjitha keto parametra që përmendëm duhet të respektohen në mënyrë të tillë që të kemi një ecuri të mirë në zenien e fidaneve dhe në krijimin e grumbullit të ri, i cili do të ketë një ndikim pozitiv si në aspektin social ekonomik ashtu edhe në atë mjedisor.

Përpara mbjelljes do të bëhet piketimi i gropave. Gropat do të kenë përmasa 40 x 40 x 40 cm dhe largësia midis gropave do të jete 3 x 2 m. Në 1 ha do të hapen 1667 gropa.

Gjatë hapjes së gropave, dheu i gërmuar do të vendoset i ndarë nga njeri-tjetri (në shtresa). Gjatë hapjes së gropave, gjysma e dheut (i shtresës së sipërme) të hidhet në krahun e majtë të gropës, ndërsa gjysma tjetër (i Shtresës së poshtëme) në krahun e djathtë. E kundërta do të ndodhë gjatë procesit të mbushjes e mbjelljes së fidanit. Mbjellja e fidanave të bëhet në periudhën e pushimit të vegjetacionit, në ditë pa ngrica, në mënyrë që të mos dëmtohet sistemi rrënjor nga ngricat.

Transporti i fidanave brenda parcelës do bëhet me krah. Gjatë transportit dhe shpërndarjes së fidanave në objekt duhet të tregohet kujdes në mënyrë që ata të mos dëmtohen mekanikisht. Shpërndarja e fidanave sipas llojeve do bëhet në funksion të formulës së parashikuar për ç' do parcelë.

Mbjellja do të bëhet nga dy punëtor të specializuar dhe instruktuar paraprakisht nga specialistët përkatës për mënyrën e kryerjes së këtij procesi. Në fillim do të hidhet në gropë dheu i pjesës së sipërme të ndarë gjatë hapjes së gropës. Para mbjelljes do të hiqet me kujdes qeska e plasmasit në mënyrë që të mos krijojë shkëputje të sistemi rrënjor të fidanit nga shtresa e dheut. Kur ne fund të qeskës ka rrënjë të përdredhur, ato shkurtohen me kujdes me gërshërë të posaçme.

Fidani me bukë dheu, vendoset në qëndër të gropës, në mënyrë që të ruhet skema e mbjelljes. Qafa e rrënjës së fidanit të jetë 2–3 cm nën nivelin e pjesës së sipërme të gropës. Gropa mbushet me dhe anash fidanit duke e ngjeshur here pas here me kujdes, në mënyrë që të sigurohet kontakti i dheut të fidanit me atë të hedhur në gropë. Gjatë mbushjes së gropës me dhe dhe ngjeshjes, të tregohet kujdes në mënyrë që fidani të ruhet i padëmtuar. Pas mbjelljes së fidanit, dheu do të ngjeshet me kujdes, në mënyrë që të eliminohen flluskat e ajrit të tokës të cilat influencjnë negative në drejtim të zenies së tij. Në zona të thata sipërfaqes së gropës i jepet formë konkave, ndërsa në ato pjesë ku toka mund të mbajë lageshti, forma konvekse. Gurët që rezultojnë gjatë mbushjes së gropës, vendosen në pjesën e poshtëme të saj në formë muri, në mënyrë që të mbrojnë terrenin nga erozioni.

Afatet e kryerjes së punimeve, lloji dhe cilësia e fidanëve si dhe teknika e zbatimit të punimeve gjatë mbjelljes, do të zbatohen dhe gjatë procesit të zëvendësimeve, i cili do të kryhet vitin e dytë pas mbjelljes.

3.3. Skema, formula dhe metoda e pyllëzimit,

Skema e mbjelljes 3 x 2 m. Duke marrë parasysh konfiguracionin e terrenit si dhe nevojën e llojeve të zgjedhur për ushqim e dritëzim, kjo skemë garanton zhvillim normal të Pishës së Zezë dhe Panjës së Malit dhe përshtatet me konfiguracionin e terrenit.

Formula e pyllëzimit do jetë 70 Pishë e Zezë dhe 30 Panjë Mali.

Për realizimin e pyllëzimit do të përdoren fidanë të moshës 2 vjeçare me bukë dheu (qeska).

Metoda e pyllëzimit do të jetë me fidanë të cilët duhet të jenë në gjendje shumë të mirë vegjetative dhe të jenë të pajisur me certifikatë fitosanitare. Do të preferohen fidanë që janë mbjellë në fidanishte në zonat malore të afërta me objektin dhe ku kushtet ekologjike janë të ngjashme.

3.4. Materiali mbjellës:

Fidanët që do të përdoren për mbjellje do të jenë fidanë 2 vjecarë të llojit Pishë e Zezë (Pinus Nigra) dhe Panjë Mali (Acer Pseudoplatanus) të çertifikuar (me çertifikatë origjine dhe cilësie) brenda standarteve shtetërore. Fidanat duhet të kenë sistem rrënjor të zhvilluar mirë, të pa dëmtuar, pa pjesë të thara. Trupi të jetë i drunjëzuar, i pa dëtuar, i drejtë, i pa bigëzuar, me sytha të zhvilluar normalisht dhe të pa çelur. Fidani të jetë i pa prekur nga sëmundje apo dëmtues, gjithashtu të jetë i freskët dhe jo i mpirë nga ngricat apo mungesa e lagështirës.



Mundësisht fidanët duhet të jenë të prodhuar nga ndonjë fidanishte e zonës afër objektit të pyllëzimit ose në ndonjë vend tjetër që ka kushte atmosferike dhe gjeografike të njëjta ose të përafërta me objektin ku do të kryhet pyllëzimi. Transportimi i fidanave behet me çdo lloj mjeti, por gjithmone me rrënjët e mbuluara pamvaresisht nga largësia. Kjo do të rritë sigurinë e mos dështimit të objektit për faj të fidanëve.

Përmasat e fidanëve që do të përdoren për pyllëzim janë si më poshtë:

Nr	Lloji i fidanit	Pyllëzime në blloqe		
		Trashësia e qafës (mm)	Gjatësia e fidanit (cm)	Gjatësia e rrënjës (cm)
1	2	3	4	5
A.	Halorë			
1	Pishë e Zezë	≥ 3	≥ 8	≥15 Me tokë
B.	Fletorë			
1.	Panjë Mali	≥ 10	≥ 100	≥20 Me tokë

Nevojat për fidanë:

Nr.	Lloji	Nj. Matjes	Gjithsej	Nga kjo	
				Pyllëzime	Zëvendësime
1	Pishë e Zezë (me tokë)	Cope	28 182	24 507	3 675
2	Panjë Mali	copë	12 075	10 500	1 575
3	TOTALI	copë	40 257	35 007	5 250

3.5. Koha e kryerjes së punimeve:

Procesi i pyllëzimit do të bëhet gjatë periudhës së pushimit të vegjetacionit konkretisht periudha Tetor- Mars. Në vendet malore, për shkak të kushteve atmosferike kjo periudhë mund të zgjatet deri në 15 Prill.

Sigurimi i materialit mbjelles (fidanëve) duhet të bëhet më parë se të fillojë hapja e gropave, për arsye që kur të hapen gropat të mos kemi vonesa.

Duhet të mbahet parasysh se gropat duhet të rrinë mbi 1 muaj të hapura, për tu rrahur nga agjentet atmosferike.

3.6. Parashikimi i përqindjes së zënieve:

Përqindja e zënieve parashikohet në pranverë 95 % dhe në vjeshtë 80 %. Në funksion të përqindjes së zënjeve të vjeshtës, përcaktohet numri i fidanëve që do zëvendësohen. Zëvendësimi i fidanave të tharë, do të bëhet sezonin pasardhës të mbjelljeve. Sasia e fidaneve që do të zëvendësohen është e njëjtë me numrin e atyre që janë tharë.

Objekti parashikohet që të mirëmbahet për 3 vite. Në fund të vitit të tretë, në menyrë që pyllëzimi të jetë i suksesshëm, përqindja e zënieve parashikohet të jetë $\geq 80\%$.

3.7. Shërbimet kulturele dhe ruajtja:

Pas perfundimit të pyllëzimeve në vitin pasardhës do të kryhen zëvendësime në masën 15 % për fidanët e dështuar në vitin e parë si dhe pas monitorimit dhe verifikimit të zënieve në muajin shtator.

Ujitja, parshitja e fidaneve si dhe heqja e barërave të këqia do të bëhet në vitin e parë, të dytë dhe të tretë të mbjelljes. Prashitjet do të shoqërohen me plehërim kimik (Dap ose Nitrat), duke përdorur rreth 1.66 kv/ha për çdo prashitje. Fillimisht hidhet nga një dorë pleh duke përdorur rreth 100 gram për çdo fidan, pastaj kryhet procesi i prashitjes. Duhet patur kujdes që plehu të hidhet vetëm për sasinë e fidanave që mund të prashiten brënda ditës pasi në rast se ai mbetet i pa mbulluar i humbet elementët ushqyes të bimës.

Prashitja bëhet me vegla të thjeshta pune (Shatë), duke u përshtuar me punime sipërfaqja rreth fidanit me rreze 0.3 m nga fidani e thellësi 10 – 15 cm. Gjatë prashitjes të bëhet shkriftimi i dheut dhe heqja e bimëve barishtore. Në periudhën e thatë të verës do bëhet ujitja e fidanëve. Në vitin e parë pas mbjelljes, janë planifikuar 2 ujitje duke përdorur 30 litër ujë për fidan. Ujitjet do të bëhen gjatë muajve Korrik-Gusht.

Koha e kryerjes së prashitjeve do të jetë periudha Qershor - Korrik. Rekomandohet që prashitjet të bëhen 2-3 ditë pas rënies së shirave ose uitjes, në mënyrë që të ruhet sa më shumë lagështira në gropë. Objekti duhet të mbrohet nga kullotja për 3 vjet dhe në rast të shfaqjeve të dëmtuesve apo sëmundjeve duhet të bëhet luftimi i tyre. Të gjitha këto punime, do të jenë pjesë e investimit të këtij objekti, duke ndikuar në sigurimin e përqindjes së zënies së planifikuar dhe zhvillimin e mëtejshëm të grumbullit pyjor.

KAPITULLI I IV

4.1. Grafiku i punimeve:

Afati i zbatimit

”Procesi i mbjelljes bëhet gjatë periudhës së pushimit të vegjetacionit konkretisht periudha Tetor- Mars. Në vendet malore, për shkak të kushteve atmosferike kjo periudhë mund të zgjatet deri në 15 Prill.”.

Shërbimet e tjera që do të kryhen mbas mbjelljes do të shtrihen brenda tre viteve nga mbjellja e fidaneve.

4.2. Analiza e Riskut:

Rreziqet me të medha për mos funksionimin dhe realizimin e këtij projekti janë mungesa e fidaneve, koflikti për vendin ku do të pyllëzohet etj. Për këtë, gjatë informacioneve të marra në Njesinë Administrative Voskopojë, rezulton se popullsia vendase dhe kryesia e fshatit kanë shfaqur dakortësinë për realizimin e këtij projekti.

Në kuadrin e një analize të plotë dhe të gjithanshme të vleresimit të të gjithë faktoreve që ndikojnë në përkeqësimin e tregueseve të performancës dhe qendrueshmerise afatgjate te objektit te pyllëzimit do të konsideronim si faktorë rrisht:

- Cilësia e kryerjes së punimeve dhe materialit mbjellës (Fidanëve pyjorë).
- Ekzistenca e një periudhe të gjatë kohe pa reshje (2- muaj) dhe temperatura ekstreme të larta.
- Dëmtimi i objektit nga kullotja e bagetive.
- Prania e ndonjë zjarri eventual dhe të rastesishëm.
- Mos realizimi i shërbimeve kulturele të planifikuara.

Pra duke parë me kujdes faktorët e mësipërm të cilët çojnë deri në kompromentimin e ekzistencës së objektit të pyllëzimit, përfituesi i financimit duhet të marrë masat e duhura tekniko- organizative, për zbutjen apo eliminimin e faktorëve të riskut si dhe mbrojtjen e objektit për një periudhë 3 vjeçare.

4.3. Qëndrueshmëria e projektit:

Në arritjen e objektivave të planifikuara në këtë projekt, atë të mbjelljes së fidanëve pyjor të llojit Pishë e Zezë dhe Panjë Mali do të ndryshojë qeverisja e kësaj parcele, do të shtohet fondi pyjor, do shtohet volumi, do të shtohet sipërfaqja e trungishteve, do ketë aktivitete të tjera në kuadër të këtij pyllëzimi si zëvendësime prashitje ujitje. Grumbulli pyjor që do të krijohet, i trajtuar sipas projektit, në aspektin e funksionalitetit dhe të qëndrueshmërisë, do të sjellë në vazhdimësi rritje të vlerave ekonomike, ku përfshihen, krijimi i kushteve për shtimin e faunës dhe florës, përfitimet në stokimin e karbonit si dhe përfitime ekonomike në të ardhmen nga lënda drusore që rezulton nëpërmjet trajtimeve e ndërhyrjeve silvikulturele dhe ekologjike të tij.

4.4. Ndikimi social ekonomik:

Gjatë realizimit të këtij projekti, do të ketë mundësi punësimi për banoret e fshatrave në afërsi të objektit. Gjithashtu realizimi i këtij projekti shoqërohet dhe me vlera të veçanta për zonën në aspektin social dhe rekrativ, pasi pas disa vitesh e shoqëruar kjo me të ardhura për zonën, shtim të materialit drusor, rritje të masës së gjelbërt në këto fshatra, frenimin e humbjes së mëtejshme të tokës nga rrëshqitjet si dhe me shume karbon i stokuar, duke përmisuar edhe më shumë cilësinë e ajrit, te ujrave etj. Të gjitha këto, sjellin pozitivitet në kuadër edhe të një mjedisi më të pastër, të përmirësimit të gjëndjes ekonomiko financiare të komunitetit për rreth, përmirësimin e peiszhit si dhe nëdërgjegjësimin e komunitetit për mbrojtjen dhe menaxhimin e qëndrueshëm të fondit pyjor/kullozor.

4.5. Vlerësimi dhe Monitorimi:

Indikatorët kryesor teknik dhe mjedisor që do monitorohen gjatë zbatimit dhe të punimeve dhe mirëmbajtjes së objektit janë:

1. Numri i drureve për ha do të jetë 1667 copë.
2. Kurorëndësia e grumbullit ose grada e mbulimit nuk do të bjerë nën 0.7 ose 70 % në inventarizimin e parë pas përfundimit të mbjelljeve.
3. Diametri mesatar mbi 3 mm, lartësia mesatare mbi 20 cm, për Pishën e Zezë dhe Panjën e Malit.
4. Madhësia e gropës do të jetë 40 x 40 x 40cm.

Ndikimet që do të ketë në mjedis gjatë kryerjes së punimeve të pyllëzimit të siperfaqeve të parcelave ndahen në:

- ndikime gjatë zbatimit të punimeve
- ndikime pas përfundimit të punimeve

Këto ndikime përfshijnë mjedisin ekologjik, fizik si dhe faunën e zonës. Ndikimet negative të shkaktuara nga aktivitetet e njeriut, gjatë fazës së zbatimit dhe fazës së operimit janë jetëshkurtër dhe do të zhduken kur projekti të përfundojë. Kështu gjatë kryerjes së punimeve disa nga ndikimet në mjedis do të jenë:

- Punimet përgatitore për mbjellje dhe ndërtimi i rrugëve brenda ngastrës pyjore do të sjellin nxitje të erozionit të tokës në një masë të kufizuar.
- Përdorimi mjeteve të transportit si dhe makinerive për kryerjen e punimeve do të shkaktojnë ndikime në emetimeve e gazeve serë nga djegia e karburantit.
- Po kështu zhurmat gjatë kryerjes së punimeve janë një tjetër ndikim negativ që do të shkaktohet në mjedis, duke sjellë shqetësime edhe për faunën në objektin e pyllëzimit.
- Plehurat kimike të përdorur gjatë mbjelljes dhe shërbimeve kulturore, mund të ndikojnë negativisht në kontaminimin e tokës dhe ujrave, prandaj duhen përdorur me kujdes dhe duhet hedhur sasinë e nevojshme.

Ndërsa ndikimet pas përfundimit të punimeve, në përgjithësi konsiderohen si ndikime pozitive në mjedis sepse:

- Pas përfundimit të projektit, shkalla e mbulimit të vegetacionit do të rritet dhe do të sigurohen përfitime mjedisore, për shkak të rritjes së nivelit të shërbimeve në mjedis që ofron pylli i krijuar.
- Do të rritet kapaciteti i strehës dhe ushqimit për faunën në objekt.
- Kryerja e pyllëzimit do të ndikojë pozitivisht në stabilizimin e tokës.
- Grumbulli pyjor i krijuar do të rrisë kapacitetin absorbues të gazeve sere e sekuestrimit të karbonit.
- Do të kemi një përmirësim të mjedisit ekologjik.

KAPITULLI V

ANEKSE

5.1 SKEMA E MBJELLJES



5.2. Foto satelitore e pozicionimit të objektit



Foto të gjëndjes egzistuese të objektit që do të pyllëzohet



5.3. Përshkrimi i llojit që do të përdoret për pyllëzim:

Pisha e Zezë (Pinus nigra), është dru përherë i gjelbëruar. Në funksion të kushteve stacionale lartësia varion nga 20-45 m, diametri varion nga 1-2 m në pjekuri. Ka një sistem rrënjor anësor të fuqishëm, gjë që lejon ti shtrije ato dhe në tokat skeletike të cekta. Druri është i pasur me rrëshirë, me myje të kuqe në gështenjë, i lehtë për tu punuar. Lëkura është e hirtë deri në të verdhë-kafe, dhe është e ndarë gjerësisht nga prerje flakëruese në formë pllakash, duke u bërë gjithnjë e më shumë të ndara me kalimin e moshës. Gjethet në formë halash ("gjilpëra"). Halat i ka të vendosura nga dy së bashku dhe të grumbulluara në majën e biskut, të gjata 8 – 14 cm, të forta, me majë shpuese, anash me dhëmbë te imët, në ngjyrë të gjelbërt të errët, që qëndrojnë 4 – 6 vjet. Boçet rrine nga dy së bashku dhe janë simetrike, pa bisht ose me bisht shumë të shkurtër dhe kanë formë vezake deri vezake – konike (4 – 8 (10) cm x 3 – 5 cm), me ngjyrë gështenjë të shndritshme. Boçet piquen në vjeshtën e vitit të dytë pas lulezimit dhe hapen në pranverën e vitit të tretë. Fara janë gri të errët, 6-8 mm të gjata, me një krah të verdhë të prerë 20-25 mm të gjatë, ato shpërndahen nga erërat kur boçet janë të hapura në periudhën dhjetor-prill. Drurët në masiv, në kushte ekologjike optimale frutifikojnë në moshën 20-40 vjeçare, Frutifikojnë çdo 2-5 vjet. Rritet në lartësi rreth 30-70 cm. në vit. Kurora ka formë vezake - piramidale, relativisht të e dendur, e përshkueshme nga drita, me degë të vendosura në mënyrë qerthullore, e cila me kalimin e kohës zgjerohet dhe merr formën e një ombrelle. Tek druret e rinj, vetkrasitja fillon rreth moshës 8 – 10 vjeçare, ndërsa shenjat e degëve të rënë mbulohen dhe mbas 25 – 35 vjetësh nuk duken më. Është specie dritë - kërkuese (Dritëdashëse). Ajo ka nevojë për diell të plotë që të rritet mirë, është intolerant i hijes, dhe është rezistent ndaj erës, thatësisë, dëborës, ngricave dhe temperaturave të ulëta duke ju rrezistuar temperaturave nga -25 °C deri-30 °C. Është lloj me rritje të shpejtë ndonëse në fillim ajo është e ngadalshme dhe rreth moshës 20 vjeçare rritja fillon dhe intensifikohet dhe arrin kulmin në moshën 50 – 60 vjeçare, ku dhe pas kësaj fillon dhe ngadalësohet. Përdoret dhe si dru dekorativ pasi ka kuror të gjelbërt gjatë gjithë periudhës së vitit.

Foto. Pinus nigra (në periudhën e frutifikimit)



Panja e Malit (*Acer pseudoplatanus*), është një dru gjethegjërë- rënës që arrin 20-35 m lartësi, me një kurorë të gjërë. Vetëm në drurët e rinj lëvorja është e lëmuar dhe gri por bëhet e kuqërremtë me kalimin e moshës dhe ndahet në shkallë. Gjethet janë të përkundrejta, të gjera, 10-15 cm të gjata, me një bisht 5-15 cm, me teksturë lëkurore, të nervuara në mënyrë pëllëmbore, me pesë vriguj të dhëmbëzuar. Gjethja e gjelbër skuqet dhe zverdhet në tharje duke i dhënë pyllit një pamje magjepsëse në stinë të ndryshme. Lulet monogame dhe hermafrodite të verdha në jeshile prodhohen në pranverë në lulesa 10-20 cm, me 20-50 lule në cdo lulesë. Pllenohet me anë të insekteve. Farat kanë një diametër 5-10 mm, shojza dyfishe me një flatër 20-40 mm që i shërben për tu përhapur nëpërmjet erës. Farat piqen në vjeshtë rreth 6 muaj pas pjalmimit. Panja e malit është e aftë të riprodhohet në mënyrë vegjetative nga rrënjët nëse ato ekspozohen në dritën e diellit. Ajo është e shquar për tolerancën kundrejt erës dhe ndotjes urbane. Ajo ka vlera ekologjike të larta, që në përzierje me specie të tjera mund të krijojë grumbuj me struktura të ndryshme. Lëgusha përnirëson formimin e humusit dhe riciklimin e lëndëve ushqyese. Panja e malit maturohet në moshën 15-20 vjet.



5.4 Specifikime teknike

-Të përgjithshme

Fidanët duhet të kenë sistem rrënjor të zhvilluar, të mos kenë dëmtime mekanike dhe fitosanitare
Fidanët duhet të jenë të pajisur me çertifikatë origjine.

Fidanët duhet të jenë të pajisur me çertifikatë fitosanitare

Garancia 3 vjet duke përfshirë të gjitha shërbimet (edhe ujitjen)

Punimet përgatitore: Piketimi dhe përgatitja e tokës.

Fillimisht bëhet pastrimi i objektit nga shkurret, drizat dhe barishtet e këqija. Pas pastrimit, në zbatim të skemave të mbjelljes bëhet piketimi i terrenit.

Piketimi bëhet nga dy punëtorë, nën drejtimin e specialistit. Gjatë përcaktimit të distancës ndërmjet rrjeshtave, në funksion të pjerrësisë së terrenit, të bëhet reduktimi i distancës sipas tabelave të posaçme ose me metoda të thjeshta të cilat mund të realizohen nga specialist me përvojë.

Pas piketimit, fillon hapja e gropave. Gropat do kenë dimensione 40 x 40 x 40 cm. Piketa e vendosur përcakton mesin e gropës. Gjatë hapjes së gropës, shtresa e sipërme e dheut duhet të ndahet nga shtresa e poshtme. Në mënyrë që lagështira e tokës të ruhet sa më gjatë, fundi i gropës duhet të ketë pak pendencë nga pjerrësia e shpatit.

- **Sigurimi i materialit për mbjellje.**

Faktor kryesor dhe mjaft i rëndësishëm në realizimin e përqindjes sa më të lartë të zënieve dhe zhvillimit normal të grumbullit pyjor është cilësia e fidanëve dhe farës që do përdoren për mbjellje.

Fidanat të jenë 2 vjeçar, brënda parametrave cilësor të përcaktuara në standartet në fuqi, të pa prekur nga sëmundje e dëmtues. Trashësia e qafës së fidanit të jetë mbi 3 mm, gjatësia e fidanit mbi 8 cm dhe gjatësia e rrënjës mbi 15 cm me bukë dheu.

Fidanat duhet të jenë të shoqëruar me dokument origjine dhe të çertifikuara nga strukturat përkatëse.

- **Teknika e mbjelljes.**

Mbjellja e fidanave të bëhet në periudhën e pushimit të vegjetacionit, në ditë pa ngrica, në mënyrë që të mos dëmtohet sistemi rrënjor nga ngricat.

Transporti i fidanave brënda parcelës do bëhet me krah. Gjatë transportit dhe shpërndarjes së fidanave në objekt duhet të tregohet kujdes në mënyrë që ata të mos demtohen mekanikisht. Shpërndarja e fidanave do bëhet në funksion të formulës së parashikuar.

Mbjellja do të bëhet nga dy punëtor të specializuar dhe instruktuar paraprakisht nga specialistët përkatës për mënyrën e kryerjes së këtijë procesi. Në fillim do të hidhet në gropë dheu i pjesës së sipërme të ndarë gjatë hapjes së gropës. Kur në fund të qeskes ka rrënjë të përdredhur, ato shkurtohen me kujdes me gërshërë të posaçme.

Fidani vendoset në qendër të gropës, në mënyrë që të ruhet skema e mbjelljes. Qafa e rrënjës së fidanit të jetë 2 – 3 cm në nivelin e pjesës së sipërme të gropës. Gropa mbushet me dheu anash fidanit duke e ngjeshur here pas here me kujdes, në mënyrë që të sigurohet kontakti i dheut të fidanit me atë të hedhur në gropë. Gjatë mbushjes së gropës me dheu dhe ngjeshjes, të tregohet kujdes në mënyrë që fidani të ruhet i padëmtuar. Pas mbjelljes së fidanit, dheu do të ngjishet me kujdes, në mënyrë që të eliminohen flluskat e ajrit të tokës të cilat influencojnë negativisht në drejtim të zënies së tij. Në zona të thata sipërafqes së gropës i jepet formë konkave, ndërsa në ato pjesë ku toka mund të mbajë lagështi, forma konvekse. Gurët që rezultojnë gjatë mbushjes së

gropës, vendosen në pjesën e poshtme të saj në formë muri, në mënyrë që të mbrojnë terrenin nga erozioni.

Afatet e kryerjes së punimeve, lloji dhe cilësia e fidanëve dhe farës si dhe teknika e zbatimit të punimeve gjatë mbjelljes, gjatë procesit të zëvendësimeve, i cili do të kryhet vitin e dytë pas mbjelljes, do jenë siç u përshkruan më lart.

Shërbimet kulturale janë parashikuar që të realizohen për 3 vjet. Për vitin e parë është parashikuar që të bëhen 2 plehrime me plehra kimik me përmbajtje azoti dhe potasi, 2 prashitje, 2 uitje.

Prashitja e parë dhe e dytë do të shoqërohen me plehërim kimik. Fillimisht hidhet nga një dorë pleh duke përdorur rreth 100 gram për çdo fidan, pastaj kryhet procesi i prashitjes. Duhet patur kujdes që plehu të hidhet vetëm për sasinë e fidanave që mund të prashiten brenda ditës pasi në rast se ai mbetet i pa mbulluar i humbet elementët ushqyes të bimës

Prashitja bëhet me vegla të thjeshta pune duke u përshkruar me punime sipërfaqja rreth fidanit me rreze 30 cm. Gjatë prashitjes të bëhet shkriftimi i dheut dhe heqja e bimëve barishtore.

Në periudhën e thatë të verës do të bëhen 2 uitje duke përdorur 30 litër ujë për fidan.

Parashikimi i përqindjes së zënieve.

Në këtë objekt parashikohet që përqindja e zënieve të jetë mbi 80 % duke zbatuar me përpikmëri pikat e më poshtme:

1. Zbatimi rigoroz i teknikës së hapjes së gropave, mbjelljes së fidanit e ngjeshjes së tokës gjatë procesit të mbjelljes.
2. Cilësia e fidanëve që do të përdoren për mbjellje, të cilët domosdoshmërisht duhet të jenë të pajisur me certifikatë origjine e cilësie.
3. Afatet e zbatimit të punimeve.
4. Cilësia e zbatimit të punimeve gjatë kryerjes së shërbimeve kulturale.
5. Mbrojtja e objektit nga kullotja, dëmtimet mekanike të fidanëve dhe zjarret.